

**Burimet:** deklarata S.Xh, FDH-9231; KMKMRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; *Two Boys Died, 4 Wounded in Still Unsolved Explosion in Prizren*, pasqyra e lajmeve, KIC, 19.09.1998, FDH-29825.

### **Srdan (Živojin) Simonović**

(26.09.1978, serb nga Konjini, komuna e Lebanes, punëtor tekstili, i pamartuar, pjesëtar i UJ-së)

Pas mbarimit të shkollës së mesme, Srdani ka shkuar për ta kryer shërbimin e rregullt ushtarak në muajin qershor të vitit 1998. E ka kryer trajnimin për forcat kufitare dhe, pastaj, u sistemua në Batalionin Kufitar të 55 të Korpunit të Prishtinës/Prishtina, pranë postbllokut kufitar të **Gorozhupit/Goruzup**. Në datën **2.10.1998**, rreth orës 15:00, Srdani dhe disa kufitarë të tjerë ishin duke pushuar në afërsi të vendit të tyre të rojës, kur pjesëtarët e UÇK-së hapën zjarr ndaj tyre. Me këtë rast, Srdani gjeti vdekjen. Familjarët e kanë varrosur më 5.10.1998 në varrezat e Konjinit.

**Burimet:** deklarata Ž.S, FDH-25178; KMKMRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 63.

### **Latif (Bajram) Gallopeni**

(15.10.1975, shqiptar nga Dobërdelani/Dobrodeljane, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

### **Rrustem (Dalip) Shala**

(2.01.1978, shqiptar nga Dobërdelani/Dobrodeljane, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

### **Hasan (Destan) Shala**

(25.08.1979, shqiptar nga Banja, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

### **Shpejtım (Tafil) Kryeziu**

(18.02.1980, shqiptar nga Suhareka/Suva Reka, nxënësi, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Në datën 9.10.1998, rreth orës 17:00, Rrustemi, Latifi dhe vëllai i bashkëshortes së Latifit, Shpejtım me një grup burrash nga fshati dhe rrethina u nisën për në Shqipëri për armatime. Në kuadrin e

grupit ishte edhe Hasan Shala, po ashtu pjesëtar i UÇK-së. Përderisa po e kalonin kufirin pranë **Gorozhupit/Goruzup**, më **10.10.1998**, kanë rënë në një fushë të minuar. Latifi, Rrustemi dhe Shpejtım kanë gjetur vdekjen në vend, ndërkaq Hasani, edhe pse i plagosur rëndë, u tërhoq me grupin. Por, në rrugë e sipër, ai ndërroi jetë. Një nga bashkëluftëtarët e ka bartur trupin e tij të pajetë në fshatin Vllanë, në Shqipëri, dhe atje e ka varrosur. Pas dy ditësh, ushtarët serb i kanë çuar trupat e Latifit, Rrustemit dhe Shpejtım në morgun e Prizrenit/Prizren. Prindërit e Shpejtım u njoftuan për vrasjen e të birit dhe, më 13.10.1998, ata e morën trupin e tij nga morgu, si dhe atë të Latifit, përderisa Rrustemin nuk e kanë njohur. Po atë ditë, e kanë varrosur Shpejtım në Suharekë/Suva Reka. Pastaj, e çuan trupin e Latifit te familja e tij në Dobërdelan/Dobrodeljane, ku ai u varros po atë ditë. Të nesërmen, edhe familjarët e Rrustemit e kanë marrë trupin e tij nga morgu dhe e kanë varrosur po atë ditë në varrezat e Dobërdelanit/Dobrodeljane. Pas përfundimit të luftës, në vitin 2000, mbetjet mortore të Hasanit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës, në Klëçkë/Klečka [Lipjan/Lipljan].

**Burimet:** deklarata Xh.G, FDH-35611; deklarata A.S, FDH-11161; deklarata I.S, FDH-33444; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetordhetor 1998, 134, FDH-23857; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.P.241B, FDH-5838; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; UÇK, *Lista e dëshmoreve...*, FDH-36427; *Identity of Two Other Teenagers Killed in Serb Minefield Established*, pasqyra e lajmeve, KIC, 26.10.1998, FDH-297-79; *Four Albanians From Malisheva Killed in Minefields at Kosova-Albanian Border*, pasqyra e lajmeve, KIC, 25.10.1998, FDH-29778.

### **Sami (Vehbi) Kryeziu**

(29.10.1980, shqiptar nga Pagarusha/Pagaruša, komuna e Malishevës/Mališevo, nxënësi)

### **Enver (Milazim) Bytyqi**

(17.10.1982, shqiptar nga Shkoza/Milanović, komuna e Malishevës/Mališevo, nxënësi)

### **Kujtim (Brahim) Bytyqi**

(1983, shqiptar nga Shkoza/Milanović, komuna e Malishevës/Mališevo, nxënësi)